REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr.21034/1 prot. Vlorë, më 21.10.2026

PROJEKTVENDIM

Nr._____datë ____._____2026

PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET NË NEVOJË, TË CILAT NUK MUND TË PËRBALLOJNË ME TË ARDHURAT E TYRE QIRANË E TREGUT TË LIRË.

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 8 pika 1dhe 2, neni 9 pika1.1/b, neni 24 pika 1.2, të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", të ndryshuar neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", të VKM Nr.384 datë 12/06/2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", të VKM Nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si edhe kushtet e standartet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët", pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Drejtoria e infrastrukturës dhe Investimeve Publike dhe Vendimin e Komisionit të Strehimit të Bashkisë Vlorë;

VENDOSI

I. Të miratojë subvencionin e qirasë që përfitojnë familjet në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë me të ardhurat e tyre qiranë e tregut të lirë, emrat sipas tabelës bashkëlidhur.
II. Afati i përfitimit të subvencionit të qirasë është 1 vit nga data e paraqitjes së kërkesës së aplikantëve pranë Bashkisë Vlorë .
III. Efektet financiare sipas pikës I, do të mbulohen nga buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2026 e në vijim.

LISTA E FAMILJEVE / INDIVIDËVE QË PËRFITOJNË SUBVENCIONIN E QIRASË NË TREG TË LIRË PËR VITIN 2026
grupi i katërt

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Kategoria sipas nenit 16 të ligjit nr.22/2018	Përbërja familjare	Struktura e ap. sipas normave të strehimit	Siperfaqja e ap.m2 sipas kontra-tës qirasë	Qiraja mes.e apart. në treg për strukturën që I takon	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria sipas pikës 45 të nenit 2 të ligjit 22/2018	Aftësia përball. e familjes	Qiraja e përball.	Sub-vencioni mujor
1	Xhevaire	Selman	Imaj	1 fëmijë PAK	4	2+1	75	25000	54028	A.sh.ulëta	15%	8104	15895
2	Floreta	Merko	Lekaj	familje njëprindërore	4	2+1	106,24	25000	12372	A.sh.ulëta	15%	1856	23144
3	Dallandyshe	Rustem	Mataj	e moshuar në pension anëtar I kom.egjiptian	1	garsonierë	61	15000	11021	A.sh.ulëta	15%	1653	13347
4	Yllka	Haki	Demiraj	e moshuar në pension	1	garsonierë	42	15000	18923	A.sh.ulëta	15%	2838	12162
5	Elbama	Theodhori	Kiço	fam.njëpr.vajza nëna	2	1+1	58.2	20000	8364	A.sh.ulëta	15%	1255	18745
6	Kleida	Festim	Dulaj	fam.njëpr.vajza nëna	2	garsonierë	45	15000	0	0	0%	0	15000

IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike, si edhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë Vlorë.

V. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 date 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETAR

Brunilda Mersini

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
DREJTORIA E INFRASTRUKTURËS DHE INVESTIMEVE PUBLIKE

Nr. 21094/1 prot. Vlorë, më 21.10.2026

RELACION

Për projekt-vendimin
PËR MIRATIMIN E SUBVENCIONIT TË QIRASË QË PËRFITOJNË FAMILJET NË NEVOJË, TË CILAT NUK MUND TË PËRBALLOJNË ME TË ARDHURAT E TYRE QIRANË E TREGUT TË LIRË.

Ju informojmë se në përmbushje të kërkesave të familjeve/individëve të pastrehë për tu trajtuar me subvencionin e qirasë në treg të lirë për vitin 2026 nga Bashkia Vlorë, janë miratuar ;

1. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.29, datë 28.02.2026 19 familje dhe individë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë, me fondet e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në shumën totale 260739 lekë në muaj, 3128868 lekë në vit.
2. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.64, datë 28.05.2026 11 familje dhe individë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë, me fondet e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në shumën totale 149712 lekë në muaj, 1796544 lekë në vit.
3. Me Vendim të Këshillit të Bashkisë Vlorë Nr.82, datë 27.08.2026 11 familje dhe individë për të përfituar subvencionin e qirasë në treg të lirë, me fondet e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2026 në shumën totale 164221 lekë në muaj, 1970662 lekë në vit.

Në total janë trajtuar 41 familje dhe indidvidë me shumën mujore të përfitimit =574 672 lekë, shumën vjetore = 6 896 074 lekë.

Në mbështetje të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social" të ndryshuar, neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", në vijim kanë paraqitur kërkesat dhe dokumentacionin edhe 7 familje dhe individë të tjerë, për tu trajtuar me subvencionin e qirasë në treg të lirë nga Bashkia Vlorë.

Sipas nenit 16, të ligjit 22/2018 këto familje dhe individë bëjnë pjesë në kategoritë e mëposhtme:

1. Familje pa të ardhura.
2. Familje me individë PAK.
3. Familje njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë nën moshën 18 vjeç.
4. Të moshuar të vetmuar.
5. Anëtarë të komunitetit egjiptian.

Kërkesat dhe dokumentacioni i depozituar prej tyre janë përcjellë pranë Komisionit të Strehimit nga struktura përgjegjëse për strehimin në mbledhjen e datës 19/10/2026. Pranë komisionit është vendosur edhe procesverbali i verifikimit në fakt të banesave, përputhshmëria e vendndodhjes dhe kushteve reale kundrejt përshkrimit në kontratat e qirasë të nënshkruara midis palës qiramarrëse dhe qiradhënëse. Nga komisioni u vlerësuan kushtet sociale dhe ekonomike në të gjitha rastet, ku të ardhurat familjare për efekt të përcaktimit të qirasë së përballueshme dhe të subvencionit të qirasë, u morën nga mesatarja e periudhës 1 vjeçare para muajit të aplikimit. Për personat në pension të ardhurat merren nga vërtetimet për masën e pensionit të gjeneruara përmes portalit e-albania. Ndërsa familjet/individët përfitues të ndihmës ekonomike, ose të pagesave të aftësisë së kufizuar, konsiderohen me të ardhura zero.

Nisur nga vlerësimi i të gjitha dosjeve dhe përputhshmërisë me kushtet e kriteret e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, komisioni vendosi të miratojë trajtimin me subvencionin e qirasë të 6 familjeve. Për 1 familje me mungesa të theksuara të dokumentacionit bazë është dërguar kërkesë me shkrim për plotësim dokumentacioni.

Për familjet e miratuara nga Komisioni i Strehimit, të dhëna të detajuara për kushtet e strehimit, kushtet sociale, ekonomike, aftësinë paguese, qiranë e përballueshme, subvencionin mujor dhe vjetor që përfitojnë, janë pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij projektvendimi.

Sa më lart, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë të miratojë projektvendimin e paraqitur për të ndihmuar me pagesat e qirasë familjet në nevojë që kërkojnë mbështetje nga Bashkia Vlorë.

Specialiste

Drita Mustafai

DREJTOR

Kristaq Jorgaqi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KOMISIONI I STREHIMIT

Nr.21094 prot.

Vlorë, më 21.10.2026

MIRATOHET
KRYETAR

Brunilda Mersini

VENDIM
Nr. 14, datë 20.10. 2026

Mbi kualifikimin e familjeve në nevojë që do të përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë, grupi i katërt i përfituesëve për vitin 2026.

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 datë 03.05.2018 "Për strehimin social", neni 2 pika 34/a,b,c, pika 35, pika 36, pika 42, neni 33, neni 38, të VKM Nr.362 datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", të VKM Nr.459 datë 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë dhe uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", Komisioni i Strehimit të Bashkisë Vlorë, i mbledhur sot në datën 20.10 .2026, pasi mori në shqyrtim kërkesat e qytetarëve dhe dokumentacionin e depozituar prej tyre, për të përfituar nga projekti i subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2026;

KONSTATOI SE

Deri në datën e sotme kanë paraqitur kërkesat 7 familje dhe individë të pastrehë, që banojnë me qira në tregun e lirë, në pamundësi ekonomike për të përballuar me të ardhurat e tyre pagesat e qirasë. Bashkë me pamundësinë ekonomike këto familje paraqesin një sërë problematikash familjare dhe sociale.

Për të gjitha aplikimet, pranë komisionit është vendosur kërkesa dhe dokumentacioni i depozituar pranë Bashkisë Vlorë, si edhe procesverbali i verifikimit në fakt të banesave, i kryer nga specialistja e strehimit në bashkëpunim me punonjësit e rajonit, ku ndodhen banesat e marra me qira, përputhshmëria e vendndodhjes dhe kushteve reale kundrejt përshkrimit në kontratat e qirasë të nënshkruara midis palës qiramarrëse dhe qiradhënëse.

*1 aplikim është me vijim kontrate, personi është përfitues i subvencionit të qirasë në vitet e mëparëshme,

*6 aplikime janë të reja, ose aplikim për herë të parë në vitin 2026.

Në komision u shqyrtuan kërkesat, dokumentacioni dhe përputhshmëria ligjore për secilin rast, lidhur me kushtet e strehimit, ekonomike, sociale dhe familjare. U vlerësuan të ardhurat mujore neto, ku të ardhurat familjare për efekt të përcaktimit të qirasë së përballueshme dhe të subvencionit të qirasë, u morën nga mesatarja e periudhës 1 vjeçare para muajit të aplikimit për personat e punësuar. Për personat në pension të ardhurat merren nga vërtetimet për masën e pensionit të gjeneruara përmes portalit e-albania. 1 aplikantë rezulton pa të ardhura, ose të ardhura 0.

Nga komisioni u vlerësua masa e qirasë sipas kontratës kundrejt qirasë mesatare në treg të miratuar me VKB Nr.107, datë 18.12.2024, aftësia përballuese, qiraja e përballueshme dhe subvencioni mujor e vjetor në çdo rast.

Sa më lart komisioni

VENDOSI:

1. Të miratojë trajtimin me përfitimin e subvencionit të qirasë në vlerat mujore dhe vjetore, personat sipas tabelës së mëposhtme.

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Përbërja Familjare /kushtet sociale	Struk.apartam. sipas normave të strehimit	Qiraja mesatare në treg për strukt. që i takon	Të ardhurat familjare	Aftësia përballuese	Qiraja e përball.	Subven. mujor	Subven. vjetor
1	Xhevaire	Selman	Imaj	4, 1 fëmijë PAK	2+1	25000	54028	15%	8104	15895	190740
2	Floreta	Merko	Lekaj	4, familje njëprindërore	2+1	25000	12372	15%	1856	23144	277728
3	Dallandyshe	Rustem	Mataj	1, e moshuar, kom.egj.	garsonierë	15000	11021	15%	1653	13347	160164
4	Yllka	Haki	Demiraj	1 e moshuar e vetmuar	garsonierë	15000	18923	15%	2838	12162	145944
5	Elbama	Theodhori	Kiço	2, fam.njëpr. vajza nëna	1+1	20000	8364	15%	1255	18745	224940
6	Kleida	Festim	Dulaj	2 fam.njëpr. vajza nëna	garsonierë	15000	0	0	0	15000	180000

2. Një familje me mungesa të theksuara të dokumentacionit bazë është njoftuar me shkrim mbi plotësimin e tij. Kërkesa do të rishqyrtohet mbas depozitimit të dokumentacionit të plotë.

3. Mbi vendimet e këtij komisioni Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike të përgatisë projektvendimin, i cili do të paraqitet për miratim në Këshillin e Bashkisë në mbledhjen e këtij muaji.

KOMISIONI:

Klea Lalo	Kryetar
Kristaq Jorgaqi	anëtar
Mirela Mishgjoni	anëtar
Skerdilajd Hunda	anëtar
Besi Gjondeda	anëtar
Elidon Jaho	anëtar
Ledia Sholla	anëtar
Hiqmet Gacaj	anëtar
Genard Fegaj	anëtar
Kanan Shakaj	anëtar
Igli Binaj	anëtar
Drini Harizaj	anëtar
Drita Mustafai	anëtar